# Viaggio in Albania con la casa a ruote di Ilir Mati

E' cominciata la stagione turistica d'estate in Albania. Mi trovo con un gruppo di amici, tutti pensionati provenienti da diverse città d'Italia. Li unisce la passione collettiva per il viaggio nel mondo con i loro camper.
I camper sono veicoli adatti per viaggiare "casa su ruote"; questa primavera questa gente coraggiosa ha deciso insieme, di visitare l'Albania.
Per 15 giorni nel Paese delle Aquile.
Da nord a sud, da est a ovest.

Lo scopo della visita è di concretizzare la conoscenza della natura e della cultura d'Albania e degli albanesi. Decidere di viaggiare in camper nelle strade d'Albania è una impresa difficile, **"perché spesso sui media si parla di strade inadatte, traffico caotico e mancanza di strutture d'accoglienza per questa tipologia di turismo"**, dice Raul Tassinari.
E' la terza volta in 5 anni che Raul viene per le ferie in Albania accompagnato dal suo cane PEPE. Perché è lui che garantisce ai suoi amici che il viaggio nel paese delle Aquile, non solo è possibile, ma anche piacevole e impressionante come in pochi altri viaggi nel mondo.
Raul, insieme a sua moglie Rosanna sono diventati stimolatori del turismo in Albania nell'Emilia Romagna. Loro partecipano a incontri dove illustrano e presentano immagini dei loro viaggi in Albania.

Tonino ha 70 anni, insieme a sua moglie Luciana sono una coppia allegra e molto curiosa. Il loro camper di 40 q.li viene guidato con perizia da Tonino, medico ginecologo di professione. Tonino è rimasto molto contento quando un guasto al suo camper è stato riparato in un centro di assistenza con parametri di tempi e professionalità come se fosse in Italia. Sono stato invitato nel loro camper e Lucia mi ha servito da mangiare piatti preparati con maestria come sanno cucinare gli italiani, anche vino delle vigne d'Umbria.
Tonino non può staccarsi dal telegiornale del suo paese e mentre lui posiziona l'antenna TV del camper, mi dice che è rimasto sorpreso perché nei bar dove si sono fermati, la gente seguiva le notizie del campionato italiano di calcio. Il pranzo è stato accompagnato dalla visione della formula uno in Turchia sulla sua TV.

Questo gruppo si compone di 5 camper. Loro viaggiano solo su strade con buon asfalto, non possono viaggiare su strade troppo deformate o danneggiate. Hanno bisogno di trovare nel loro itinerario posti dove poter parcheggiare, rifornirsi di acqua e scaricare. Questi posti ancora non si trovano nelle strade d'Albania, perciò questi servizi si improvvisano nelle aree di rifornimento e presso i parcheggi degli alberghi.

A Queparo mare, la strada finisce in una piazzola che il paese utilizza come parcheggio per camion e compattatori. Anche a Dhermi si trova un parcheggio pubblico dove i compattatori vanno a raccogliere l'immondizia buttata disattentamente lungo la trada.
A Pogradec altrettanto, perfino il comune li deve prendere esempio dalla Macedonia, per imparare in questo lavoro

Giancarlo e Lucia vengono da Verbania, bella città in riva al lago Maggiore. La loro città ha un turismo molto sviluppato e quando vedono i bei paesaggi albanesi si dispiacciono perché se la raccolta e il trattamento dell'immondizia fosse maggiore, il viaggio in Albania sarebbe più bello e impressionante. Comunque questa Lucia, - perché sono tre le Lucie in questo gruppo – è appassionata di testimonianze culturali dell'Albania -, lei spiega al gruppo nei centri archeologici, chiese paleocristiane, Bisanzio, Roma, posti che diventano oggetto del loro viaggio sulle strade albanesi.

Ennio e sua moglie Lucia, come l'altra coppia Miro e Savina, vengono dalla regione Friuli. Abitano vicino alle belle montagne sul confine Italia-Slovenia.
Tutti sono miei coetanei, sono loro che una volta mi mancavano nei miei viaggi anni e anni fa,

nella natura impressionante e nella cultura albanese, come io mancavo a loro nelle montagne e nella loro cultura italo-slovena.
La conversazione con loro scorre come l'acqua dell'Isonzo e Valbona (fiume). Ennio mi racconta che suo figlio Andrea lavora come specialista forestale in Italia e anche della figlia Elena.
La figlia di Miro, Alessandra, studia all'università per diventare ingegnere meccanico.
Io ho raccontato loro che sono diventato nonno.
Sul lago di Ohrid Miro mi ha detto che nel loro dialetto la parola "Mocra" significa umidità, terreno con acqua, bagnato.
Questa spiegazione è forse la chiave per capire il legame tra il none "Ohrid" , regione Mocra e terra umida intorno al lago Liknide, nome che porta il meraviglioso paese di Lin, sul residuo della loro chiesa paleocristiana.

Interrompo le mie note di viaggio sulla natura e sulla cultura albanese perché i miei amici camperisti mi chiamano per pranzo sui prati di Erseka, a quota 1200 mt. Savina ha preparato spaghetti al tartufo.
Poi mi hanno fatto gli auguri per una Albania che al più presto si adegui agli standard Europei, perché in Italia e in Europa ci sono tanti camperisti che vogliono visitare l'Albania e per questo ci vuole un poco di attenzione per tenere nelle più elementari condizioni di manutenzione le strade che dovranno percorrere.

*Traduzione dell'articolo scritto da Ilir Mati e pubblicato su giornale albanese durante il viaggio ALBANIA 2010*

Reportazh

## Një grup të huajsh qëndrojnë për pesëmbëdhjetë ditë turizëm në vendin e shqipeve

# Shëtitje në Shqipëri me shtëpi me rrota

ILIR MATI



Filloi sezoni turistik veror në Shqipëri. Jam me një grup miqsh. Të gjithë pensionistë nga qytete të ndryshme të Italisë. I lidh mes tyre pasioni i përbashkët për shëtitje nëpër botë me kamperat e tyre. Kamperat janë automjete të përshtatshëm për udhëtime, "shtëpi me rrota". Këtë pranverë, këta njerëz kurajozë kishin vendosur bashkërisht të vizitojnë Shqipërinë. Pesëmbëdhjetë ditë në vendin e shqipeve. Nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim. Qëllimi i vizitës ishte të konkretizonin dijet e mbledhura mbi natyrën dhe kulturën e Shqipërisë dhe shqiptarëve.

"Të vendosësh të udhëtosh me kamper nëpër rrugët e Shqipërisë, është ende punë e vështirë, sepse shpesh në mjetet e informimit flitet për rrugë të papërshtatshme, trafik kaotik dhe struktura pritëse të pa ndërtuara për këtë lloj turizmi", thotë Raul Tasinari.

Është hera e tretë që brenda pesë vjetësh Raul vjen për pushime në Shqipëri, i shoqëruar nga qeni i tij Pepe. Madje, është ai që është bërë edhe garant i miqve të tij, se udhëtimi në vendin e shqipeve jo vetëm është i mundur, por edhe i këndshëm dhe mbresëlënës, si pak udhëtime në botë. Raul madje, së bashku me gruan Rozana, janë bërë nxitës të turizmit në Shqipëri në rajonin e Emilia Romanjës. Ata marrin pjesë në takime të ndryshme ku flasin dhe shfaqin fotografitë e [illegible]rimeve të tyre në Shqipëri.

Tonino është shtatëdhjetë vjeç, bashkë me gruan e tij Luçiana, janë çift gazmor dhe mjaft kuriozë. Kamperin e tyre dyzetedy kuintalësh e drejton me mjeshtëri Tonino, mjek gjinekolog në profesion. Tonino u kënaq pa masë kur një defekt në mjetin e tij, e rregulloi në një servis me parametra, kohë dhe disiplinë sikur të ishte në Itali. Më ftuan në kamperin e tyre dhe Luçiana më priti me gjellë të gatuara mjeshtërisht ashtu si gatuajnë italianët, si dhe me verë nga vreshtat e Umbrias. Tonino nuk mund të shkëputet nga telelajmet prej vendit të vet. Ai ngriti antenën e kamperit dhe më tha se kishte mbetur i habitur se edhe në shumë bare ku kishte ndaluar, kishte vënë re se njerëzit ndiqnin lajmet, apo kampionatin italian të futbollit. Drekën tek ata e shoqëruam duke parë garat e Formula One në Turqi.

Ky grup kamperistësh përbëhet nga pesë kampera. Ata udhëtojnë vetëm në rrugë të asfaltuara mirë. Nuk mund të udhëtojnë në rrugë me gropa. Ata kanë nevojë që në itinerarin e tyre të gjejnë vende të caktuara, ku të kenë mundësi për t'u parkuar, ku të furnizohen me naftë dhe ujë dhe të shkarkojnë mbeturinat e ditës. Vende të tilla ende nuk ka në rrugët e Shqipërisë, por gjithsesi këto shërbime improvizohen në sheshe të pikave të shumta të furnizimit me karburant, si dhe në sheshe pranë hoteleve. Në Qeparo, buzë detit, rruga e asfaltuar përfundon me një shesh pushimi shumë të përshtatshëm, të cilin fshati mund ta përdorë për të nxjerrë të ardhura nga parkimi i organizuar. Po ashtu edhe në Dhërmi ka vend për një shesh parkimi publik, ku të ardhurat të shkojnë në të mirë të përpunimit të mbeturinave që shihen përgjatë rrugës të hedhura pa kujdes. Në Pogradec, po ashtu. Madje, pushteti lokal aty, mjafton të marrë eksperiencë në Maqedoni që t'i shohë hairin kësaj pune.

Xhiankarlo dhe Luçia vinë nga Verbania, një qytet i bukur buzë Lago Magiore. Qyteti i tyre është me turizëm të zhvilluar dhe kur shikojnë bukuritë e peizazhit shqiptar, iu vjen keq që për pak punë dhe organizim, në drejtim të mbledhjes dhe përpunimit të mbeturinave, shëtitja në Shqipëri bëhet më e bukur dhe më shumë mbresëlënëse. Gjithsesi kjo Luçi, sepse në grup janë tre Luçia, është e pasionuar pas dëshmive kulturore në tokën e Shqipërisë. Ajo i shpjegon grupit për qendrat arkeologjike, kishat paleokristiane, Bizantin, Romën, vende që bëhen objekt i transfertave të tyre rrugëve të Shqipërisë.

Enio dhe gruaja e tij Luçia, ashtu si dhe çifti tjetër Miro dhe Savina, vijnë nga rajoni i Friulit. Ata banojnë pranë maleve të bukura të kufirit mes Italisë dhe Sllovenisë. Të gjithë janë moshatarë me mua. Janë ata që dikur më mungonin gjatë shëtitjeve të mia, vite e vite më parë, në natyrën mahnitëse dhe kulturën e Shqipërisë, ashtu si edhe unë iu mungoja në malet dhe kulturën e tyre italo-sllovene. Biseda me ta rrjedh si ujërat e Izoncos apo të Valbonës. Enio më tregon për djalin e tij Andrea, i cili punon si mjeshtër i pyjeve në Itali dhe vajzën Helena. Vajza e Marinos, Aleksandra studion në Universitet për t'u bërë inxhiniere mekanike. Unë iu tregoj se jam bërë gjysh.

Në Liqenin e Ohrit, Marino më tha se në dialektin e tyre slloven fjala mokër, mokra, do të thotë njomishte, vend me ujë, i lagur. Ky shpjegim, ndoshta, na jep çelësin për të kuptuar lidhjen mes emrit Ohër, krahinës Mokër dhe tokave të lagështa rreth e rreth liqenit të Liknidëve, emrin e të cilëve e ruan fshati i mrekullueshëm Lin me rrënojat e kishës së vet paleokristiane.

Shënimet e mia të shkurtra për udhëtimin në natyrën dhe kulturën e Shqipërisë me miqtë e mi kamperistë, po i ndërpres sepse miqtë po më thërrasin në drekën e tyre mes lëndinave të Ersekës në kuotën 1020m. Savina ka bërë spageti me tartuf.

Ata më uruan që Shqipëria të kuptojë sa më shpejt që të jetë e mundur, se në Itali dhe në Europë, ka shumë kamperistë që duan të vizitojnë Shqipërinë. Për këtë mjafton vetëm pak kujdes për plotësimin e atyre kushteve elementare nëpër rrugët që po bëni.